




Description			
Date	7/25/2025	Location	Salla 4
		Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	
Time	Speaker	Note	
		Shënime të përmbledhura të seancës gjyqësore	
2:10:38 PM	Gjykata	Sot me datë 25.07.2024, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga: K/seance: ERJON ÇELA Asistuar nga sekretare seance Erblina Dardha, çel seancën paraprahe me dyer të mbyllura, për shqyrtimin e kërkesës penale me nr. 34/ 124 rregjistri themeltar, që i përket: Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Objekti: Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr.154 të vitit 2022. I pandehur: Arben Ahmetaj Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale të “Shpërdorim detyre” e parashikuar nga nenin 248 të K. Penal. Kjo çështje penale regjistrohet audio, krahas dokumentimit me proces-verbal, konform nenit 115 të K.Pr.Penale dhe Vendimit Unifikues Nr.1, datë 27.04.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Është paraqitur Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori e çështjes Elvin Gokaj. Nuk është i pranishëm i pandehuri Arben Ahmetaj për të cilin gjykata ma marrë vendosur të deklaronin e mungesës së tij, në bazë të vullnetit të shprehur në prokurën e posaçme të lëshuar prej tij. I pranishëm është mbrojtësi i zgjedhur prej tij, av. Henrik Ligori,	
2:11:56 PM	Avokati	Henrik Ligori i pranishëm	
2:11:58 PM	Gjykata	Relatohet faza në të cilën ndodhet gjykimi. Në seancën e kaluar gjyqësore gjykata disponoj me vendim për të thirrur në këtë gjykim shtetasin Adrian Myzeiri në cilësinë e	

		trashëgimtarit të viktimës së veprës penale, i cili është i pranishëm dhe ftohet të japë gjeneralitetet.
<u>2:12:27 PM</u>	Shtetasi	Adrian Myzeiri i biri i Eqerem dhe i Kimete, i dtl. 12.08.1967, lindur e banues në Tiranë, me kombësi e shtetësi shqiptare, me arsim të lartë, i martuar, i padënuar.
<u>2:12:54 PM</u>	Gjykata	Identifikohet me letërnjoftim me nr. 035262611.
<u>2:13:03 PM</u>	Gjykata	Gjykata konstaton që palët janë të pranishme. Duke qënë se është seanca e parë gjyqësore në të cilën paraqitet shtetasi Adrian Myderizi gjykata I jep fjalën atij për të mbajtur qëndrim në lidhje me kërkesën e prokurorit. Rezulton që keni depozituar në sekretarinë e gjykatës në datë 18.07.2025 drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilën bëni parashtrimet tuaja në cilësinë e trashëgimtarit të viktimës, në përfundim shpreheni që jeni dakord me kërkuesin e prokurorit që çëhstja penale në ngarkim të të pandehurit Arben Ahmetaj me akuzë shpërdorim detyre e parashikuar nga neni 248 i K.Penal të dërgohet në gjyq. Cili është qëndrimi juaj.
<u>2:14:29 PM</u>	Shtetasi Adrian Myderizi	Siç e kemi deklaruar, unë si trashëgimtar i familjes Myderizi kemi fituar të drejtën e pronësisë në bazë të vendimit të Komisionit të Pronave, më pas i jemi drejtuar ministrisë për privatëzimin e aksioneve shtetërore që zotëronte shteti të Buka sha, duke u mbështetur në vendimin e gjykatës kushtetuese që na njohu të drejtën si pronar të truallit të futeshim në aksionet shtetërore të Buka sha, te 51% që zotëronte shteti, në vitin 2004, në këtë kohë ministria e ekonomisë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese lëshoj një urdhër për shitjen e paketës shtetërore aksioneve të Buka sha. Meqë urdhëri ishte në kundërshtim me këtë vendim ju drejtuam gjykatës për ndryshimin e urdhërit të ministrit. Në përfundim të gjykimit gjykata vendosi u shpreh me vendosjen e masës së sigurisë për pezullimin e ekzekutimit të urdhërit të ministrit të ekonomisë së asaj kohe. Përfundimisht Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 803 datë 27.06.2006 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 3361 datë 30.05.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë ndryshim: Anullimin e urdhërit nr.11 datë 21.11.2004 të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Detyrimin e Ministrisë së Ekonomisë që të nxjerrë aktin administrativ për caktimin e formulës së privatizimit të shoqërisë "Buka" sh.a në përputhje me nenet 1 e 2 të ligjit 8334 datë 23.4.1998 si dhe akteve nënligjore që janë në fuqi, pasi të ketë përcaktuar dhe transferuar më parë pjesën e aksioneve për truallin me sipërfaqe 6370 m2 me çmimet

e tregut të lirë pronë e trashëgimtareve të Kasem e Salih Myderizit. Ligjërimin e masës për sigurimin e padisë të marrë nga Gjykata e Shkallës së parë Tiranë me vendimin nr.3663 akti datë 30.04.2004, për pezullimin e zbatimit të urdhërit nr.11 datë 21.01.2004 të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Ndaj këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë, asnjë nga palët nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. I jemi drejtuar Ministrisë së Ekonomisë me anë të zyrës së përmabrimin dhe me shkresat tona, shkresat janë të rreshtuara në pretendimet tona. Në vitin 2014 pavarësisht shkresave që u kishim drejtuar të gjithë Ministrave, nuk e zbatuan këtë vendim të formës së prerë të gjykatës. Vendimi i gjykatës së apelit mori formë të prerë dhe la në fuqi masën e sigurimit të padisë. Ne i jemi drejtuar Arben Ahmetaj me anë të Zyrës Përmbarimore dhe shkresa nga vetë ne për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, të formës së prerë të vitit 2006. Në kundërshtim me këtë vendim dhe në kundërshtim me ligjet, për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore ministri Arben Ahmetaj nxori urdhër për shitjen e aksioneve në vitin 2014. Ne morën kontakt me ministrin personalisht, ju drejtua me shkresë si familje dhe me zyrë përmbarimi ministri urdhëroj shitjen e aksioneve dhe ne ju drejtua sërish gjykatës për shfuqizimin për herë të dytë një urdhëri abuziv që ishte në kundërshtim me ligjin. Gjykata mori vendimin për shfuqizimin e urdhërit të ministrit por ndërkohë nga ministri gjatë asaj kohe u zhvillua procedura e shitjes së aksioneve shtetërore megjithëse çështja ishte në gjykatë. Kjo u bë me impenjimin e ministrit Arben Ahmetaj. Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë me vendimin nr.5300 datë 22.10.2015 është pranuar kërkesë padia e pronareve Myderizi. Me vendimin nr.4959 datë 30.11.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Me vendimin nr.77 datë 13.02.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është rrëzuar kërkesa e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. U jemi drejtuar përsëri në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit, me anë të zyrës së përmbarimit "Drenova" e cila me shumë shkresa kërkoj ekzekutimin e vendimit. Ndërkohë ne si familje bëmë edhe kallëzim penal për Arben Ahmetaj ish Ministër i Ekonomisë dhe Financës atë kohë dhe ju drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila pasi nuk kreu hetime të plota e dërgoj çështjen për pushim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, gjykata vendosi mospranimin e kërkesës së prokurorisë dhe ja ktheu mbrapsht çështjen për hetim të mëtejshëm Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bëri apel, Gjykata e Apelit e kthej dosjen për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2:24:21 PM	Gjykata	Cili është qëndrimi në lidhje me akuzën.
2:25:05 PM	Shtetasi Adrian Myderizi	Gjykatat penale edhe për herë të dyrë vendosi kthimin e akteve prokurorisë. Duke parë mosfunksionimin për të kryer një hetim ne ju drejtuam SPAK me kërkesa siç ju ju kanë ardhur. Kur kryeshin privatizimet ne na ndodhi edhe vdekja e babit nga një atak kardiak që i erdhi nga ky mosverpim. Kishim 20 vite që zotëronim pronën. Çështja duhet të kalojë për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme për çështjen penale.
2:27:06 PM	Gjykata	Parashtrimin e paraqet me shkrim. me në 10 fletë. Në seancën e kaluar bazuar në pretendimin e avokatit i la detyrë prokurorit të paraqes deklaramë të shtetasve që tregojnë rrethana të hetimit. Procesverbale deklarimi të personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit. I jepet fjala avokatit. Janë të njëjtat akte?
2:32:24 PM	Avokati	Jan pak a shumë të njëjtat. Përsëri mungojnë deklaramet e Endrit Duçkës, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave. Ne nuk na janë dhënë, të na jepen ne dhe ti jepen gjykatës. Janë deklaramet që janë shumë të rëndësishme, nuk e di pse nuk paraqiten në gjykatë.
2:32:53 PM	Gjykata	I jepet fjala prokurorit.
2:32:54 PM	Prokurori	Këto deklaramet është e vërtetë që nuk janë vu në dispozicion mbrojtjes për faktin se bëjnë pjesë hetimi në lidhje me procedurat që jemi drejtuar autoriteteve austriake për ndihmë juridike. Nuk nxjerren të dhana që nuk janë të dobishme për hetimin.
2:33:15 PM	Gjykata	Kanë lidhje këto me Arben Ahmetaj?
2:33:17 PM	Prokurori	Janë përmend shumë persona që janë duke u verifiku.
2:33:24 PM	Gjykata	Kanë lidhje me te pandehurin Arben Ahmetaj dhe gjykimin?
2:33:26 PM	Prokurori	Procedurat që ka kry te noteri, nuk ka asgja tjetër. Është shpreh me akte noteriale për momentin. Nuk kanë lidhje, janë duke u kryer verifikime në lidhje me disa të dhana që ka dhënë deklaramet vet personi. Në lidhje me këto deklaramet kemi kërku informacione të shumta, e vlerësova të mos ja vë në dispozicion mbrojtjes.
2:33:57 PM	Gjykata	I jepet fjala avokatit.
2:34:01 PM	Avokati	Në vështirmin tonë janë të gjitha të njëjtat taktika, për ta lënë gjykatën në errësirë lidhur me fakte shumë të rëndësishme, ky është një hetim, duhet ti vihen në dispozicion gjykatës, nëse gjykata vlerëson se ka sekret të madh atëher garancia jonë është gjykata, nuk mund të besojmë prokurorin që thot ka sekret të madh. Ka zero sekret, aktet kan ardh nga Austria dhe mbeten vetëm për t'u përkthyer. Nuk ka asnjë sekret por këto bëhen vetëm për të mos i vënë në dispozicion të mbrojtjes.

		Kjo që nuk ka lidhje me Arben Ahmetaj nuk është e vërtetë, sepse Endrit Duçka ka qënë sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Financave i cili ka kryer shitjen në ankand të aksioneve. Edhe përfaqësuesi i viktimave e ngatërroj. Nuk ka shitur Arben Ahmetaj ndonjë pronë, Arben Ahmetaj ka nxjerrë një urdhër për shitjen e aksioneve ashtu siç ja impononte vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe VKM, sipas cmimit të tregut. Ka thirrur ekspertët dhe ju ka caktuar detyrat që të vlerësonin këtë pronë duke përfshirë këtu edhe pjesën që i përkiste familjes Myderizi. Deklarimet e Endrit Duçkës janë marë në kuadër të procedimit nr. 154/2022, prokurori nuk mund të thotë që është ndarë procedimi dhe kanë kaluar te procedimi tjetër e nuk mund tua jap. Ne e dim si funksionin rregulli i ndarjes së dosjes. Në momentin që dosja ndahet të gjitha aktet riprodhohen dhe kalojnë edhe në procedimin e ndarë. Është rast pa precedent, unë këto ti jap këto nuk ti jap. Ne insistojmë që këto deklarime prokuroria ti paraqes në gjykatë, ka marrë vendim për këtë çështje. Ne do të pranojmë vendimin e gjykatës nëse gjykata vlerëson që fshehin prapa veprime që nuk duhet të ndahen. Lidhur me çështjen e ndarë, ai e parashtrij edhe në seancën e kaluar që veprimet që kanë për t'u bërë në atë procedim janë përkthimet e materialeve të ardhura nga Austria. Tani vetëm për të përthyer një letërporosi thot të ndaj çështjen në dy pjesë që të hidhet tym dhe të mos kuptohet ç'po ndodh në këtë proces. Prokurori duhet të vërë në dispozicion të gjykatës dhe më pas gjykata të mar vendim dhe mendon që ka gjëra sekrete që mund të dëmtojnë hetimet e prokurorit. Kjo është një alibi, hetimet i kanë përfunduar. Në lidhje me pretendimet nuk janë të vërteta, tha që nuk është zbatuar vendimi i gjykatës, nuk është e vërtetë pasi asetet e pjesës private janë vlerësuar. Krijoi bindjen që bënte shitjet Arben Ahmetaj. Ai vendosi të zbatonte politikat pro shtet, shitjen e ka bërë Ministria e Financave. Viktima nuk tha asgjë si u mbyll, nuk tha asgjë se si u tërhoq nga kjo çështje që kishte ndjekur vite me radhë si u zgjidh dhe çfarë u më me 6700 metërshi, është truall Akoma apo janë ndërtuar ato objektet që viktimat kanë përfutur. Këto gjëra mbeten të errëta për gjykatën. Nuk kam gjë tjetër.
2:39:34 PM	Gjykata	Gjykata pasi dëgjoj pretendimet e palëve bazuar në nenin 332/c, 7, 8 të K.Pr.Penale mer qëndrimin e tyre përfundimtar në lidhje me çështjen objekt gjykimi
2:39:55 PM	Prokurori	Pranimin e kërkesës. Dërgimin në gjyq të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Arben Ahmetaj.
2:39:58 PM	Avokati	Hetimet të plotësohen. Të zbatohet vendimi i gjykatës, të bashkohen procedimet. Ti vihen në dispozicion të gjitha hetimet e kryera nga prokuroria. Nuk kemi asnjë nguti të presim aktet dhe mandej duke gjykuar mbi aktet të meret një vendim në lidhje me mendimin e prokurorit. Nëse gjykata mendon që pretendimet e mbrojtjes janë të ekzagjeruara kërkojmë të pushohet pasi nuk ka asnjë fakt, nuk është



[Handwritten signature]

		përmbaarues gjyqësor i ka zbatuar të gjitha procedurat. Interesat e privatit dhe të shtetit, në këtë proces viktimë e vetme është Arben Ahmetaj. Akuzohet për fakte penale të paqëna, shtetasit që u paraqitën në cilësinë e viktimës nuk janë viktimë, ata kanë marrë nga procesi i rivlerësimit të "buka" sha, ndërkohë që z. Ahmetaj thirret në proces si i pandehur me pretendimin që ka penguar ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ndërkohë që edhe nëse do të ishte i vërtetë duhet të përgjigjej sipas 320 të K.Penal, mandej u pretendua që ka shpërdoruar detyrën, ka dëmtuar interesat e shtetit e të provatit, tani na doli që ka dëmtuar vetëm privatit por ndërkohë që kërkohet të dërgohet në gjyq për fakte të paqëna.
2:42:57 PM	Gjykata	I jepet fjala viktimës Adrian Myderizi.
2:43:09 PM	Shtetasi Adrian myderizi	Unë i qëndroj që z. Arben Ahmetaj ka tejkaluar pozicionin e tij si ministër ka marrë tagrat e një gjykatës, duke mos ekzekutuar vendimin e formës së prerë të gjykatës, që e ka urdhëruar që pasi të kalojë pjesën trashëgimtarëve të familjes Myderizi pastaj të gjej mënyrën e trajtimit të aksioneve shtetërore. Detyrimin e Ministri Zhvillimit Ekonomik Tregtise, Turizmit dhe Sipërmarrjes të nxjerrë aktin administrativ për caktimin e formulës së privatizimit të shoqërisë "Buka" sh.a në përputhje me nenet 1 e 2 të ligjit 8334 datë 23.4.1998 si dhe akteve nënligjore që janë në fuqi, pasi të ketë përcaktuar dhe transferuar më parë pjesën e aksioneve për truallin me sipërfaqe 6370 m2 me çmimet e tregut të lirë pronë e trashëgimtarëve të Kasem e Salih Myderizit. Vendimi është shumë i qartë, të kalojë pjesën e aksioneve te familja Myderizi më pas për pjesën e mbetur të bëjë ç'të dojë, të kryej një herë veprimin që nuk e ka bërë. Ne sot e kësaj dite nuk kemi marrë asnjë metër tokë, nuk kemi asnjë aksion, nuk është e vërtetë që jemi trajtë nga kjo, nuk kemi marrë asgjë. Ministri nuk ka të drejtë të vjedhi pronën e privatit para ligjit jemi të gjithë të barabartë. Ku është shkruar në Kushtetutë që shteti ka përparësi para privatit. Kjo është një e drejtë që ma jep kushtetuta. Kur ministri paska mbrojtur interesat e shtetit pse nuk e mbajti fabrikën ta përdorte për bukë, për shëndetësi, spitale e të tjera po e shiti te të tretët për ta shembur dhe për të bërë qendra tregtare. Çështja duhet të kalojë patjetër në gjyq. Nuk jam vetëm unë në këtë rol, në këtë shoqëri. Unë kam marrë kurajon i pari që të çoj një ministër përpara drejtësisë. Nëse gjykata nuk vepron për ta bërë këtë gjë atëherë kot është. Jemi dakord që çështja të kalojë për gjyq.
2:46:55 PM	Gjykata	I jepet fjala prokurorit.
2:46:59 PM	Prokurori	Pa dashur të përfshij në lidhje me aktet që ne kemi dërguar në lidhje me këtë çështje penale. Po mendoj që qëndrimi i mbrojtjes nuk mu duket shumë serioz. Se nëse i kemi ra në qafë këtij ministri, ai ka qënë përfaqësuesi ma i lartë i shtetit shqiptar dhe do të ishte shumë ma e ndershme që të vinte të mbronte pafajësinë e tij në këtë proces gjyqësor sesa t'ju fshihet drejtësisë nëpër vende të europës. Unë nuk kam gja

		personale, këto janë akte që kam paraqit, nuk i kam fsheh gjykatës as edhe një akt. Nëse gjykata më urdhëron të sjelli, të gjitha i sjell. Por ka akte të cilat nuk asht e mirë të bahen objekt nëpër mediatik, për fjalët, por janë për të bërë një hetim sa ma serioz dhe ma shterrues. Nuk kam akte të tjera për të paraqitur.
2:47:56 PM	Gjykata	I jepet fjala avokatit Henrik Ligori.
2:47:59 PM	Avokati	Kërkesat janë shumë serioze, ne kur i marim aktet nënshkruajmë dhe marim përgjegjësi. Z. Arben Ahmeta duhet të jetë apo jo në sallë është e zgjedhje sovrane e tij, ligji e lejon atë të mos paraqitet në proces, qoftë prokurori apo ndonjë autoritet tjetër nuk ka të drejtë ta paragjykojë e as ta mendojë që ai po fshihet. Ai ka tre vjet që është objekt persekucioni, me akuza të paqëna, të stisura vetëm e vetëm sepse z. Arben Ahmetaj sot politika nuk e do. Mua më duket joserioze qëndrimi i prokurorit i cili aktet i urdhëron në kuadër të një procedimi të caktuar, dhe kur i ndan në pjesë të ndarë fut ato që do dhe ato që nuk i konvenojnë sepse I bëjnë ndryshim në akuzën e tij i mban të fshehura nga vëmendja. Dy fjalë për qëndrimin e viktimës Arben Ahmetaj dhe ka dhënë formulën për privatizimin e pakestës së aksioneve shtetërore të Buka sha, zotërinjtë donin që me 8100 metër ² truall të merin 26% të aksioneve. Harrojnë që shteti kishte 32000 metër ² truall. Cila është ajo formulë që thot një vendim i gjykatës që mund të vlerësohet pjesa e tyre e ndarë, ajo është materializuar, është shkrirë, ata kanë aksione, nuk kanë tokë. Vlerësimi në raste të tilla në shoqëri tregtare bëhet për të gjitha aksionet. Zotërinjtë nga 3.71% u ka shkuar pjesa në 14% shuma është trefishuar vlera nominale e një aksioni mbi asetet që kishin futur vet në shoqëri, këtë gjë nuk duan ta kuptojnë. Formula është formula më e ndërshtme në këtë proces privatizimi, nëse Ahmetaj do të bënte këtë që kërkon pala atëher do të bënte shpërdorim detyre. U qëndrojmë pretendimeve të paraqitura.
2:51:49 PM	Gjykata	Deklarohet i mbyllur shqyrtimi gjyqësor i çështjes, gjykata tërhiqet në dhomën e këshillimit për të marrë vendimin.
3:11:28 PM	Gjykata	Gjykata mbështetur në nenet 332/dh/1 shkronja "a", 332/e, 332/f dhe 332/gj të K.Pr.Penale, vendosi: 1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. 2. Dërgimin në gjyq të çështjes penale në lidhje me propozimin penal nr. 154, të vitit 2022, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të pandehurit Arben Ahmetaj, i akuzuar për kryerjen e veprës



		penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>” e parashikuar nga neni 248 i K.Penal. 3. Urdhërohet formimi i fashikullit të gjykimit duke përfshirë në të aktet e hetimeve paraprake dhe aktet e seancës paraprake. 4. Urdhërohet depozitimi i vendimit gjyqësor të dërgimit të çështjes në gjyq së bashku me fashikullin e gjykimit në sekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykata kompetente për gjykimin e çështjes së themelit, brënda dhjetë ditëve nga shpallja e tij. 5. Kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta e ankimit. U shpall në Tiranë, sot më datën 25.07.2025
3:12:53 PM	Gjykata	Seanca deklarohet e mbyllur.

U shpall në Tiranë sot me datë 25.07.2025, sistemi i regjistrimit në audio mbyllet në ora 15.13

SEKRETARE

ERBLINA DARDHA

